



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1885, datë 19.04.2012

Për

“Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A.,”

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja c) e nenit 8, neni 52, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (**Rregullorja e Brendshme**);
3. Rregullore nr. 19 datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (**Rregullorja**);

4. Rregullore nr. 13 datë 16.04.2010 për “ Portabilitetin e Numrit” (e ndryshuar), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, Datë 07.04.2010.
5. Vendimi nr. 1468, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Eagle Sh.a”, i ndryshuar;
6. Vendimi nr. 1741 datë 20.12.2011, i Këshillit Drejtues të AKEP “Për shfuqizimin e VKD nr.1438 datë 3.11.2010 “Disa ndryshime në VKD nr.1346, datë 23.07.2010 “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile Sh.A., për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
7. Rregullore nr. 24 datë 02.02.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD Nr.1774, datë 02.02.2012.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i praktikës dokumentare mbi çështjen, të përbërë nga:

1. Shkresa e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., me Nr.Prot. 456, datë 17.02.2012 “Dërgohen propozime për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të shoqërisë Eagle Mobile”.
2. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*) ;
3. Projektvendim i KD të AKEP për “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A.” (*Projektvendimi*);
4. Materialet shkresore shoqëruese bashkëlidhur praktikës dokumentare mbi çështjen, si dhe, diskutimeve në mbledhje dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

1. Sipërmarrësi Eagle Mobile Sh.A., me shkresën Nr.Prot. 456, datë 17.02.2012 “Dërgohen propozime për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të shoqërisë Eagle Mobile” drejtuar AKEP-it, parashtron propozimet e tij për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim, për implementimin e akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP-i, konkretisht:
 - Vendimi nr. 1741 datë 20.12.2011, i Këshillit Drejtues të AKEP “Për shfuqizimin e VKD nr.1438 datë 3.11.2010 “Disa ndryshime në VKD nr.1346, datë 23.07.2010 “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile Sh.A., për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
 - VKD, Nr. 1774, datë 02. 02. 2012 “Për Miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm”.

2. Propozimet e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A. për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim, konsistojnë në:

a. Ndryshime në Pjesën e Përgjithshme, Seksionin 2 për pasqyrimin e ndryshimet e fundit në kuadrin rregullator dhe miratimine Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm me VKD Nr. 1774, datë 02. 02, 2012.

b. Ne seksionin 7 – Pjesa e Përgjithshme, pika 2 të ndryshohet si më poshtë:

Tarifat e Shërbimeve të Interkoneksionit mund të ndryshohen në përputhje me parashikimet e Ligjit nr 9918 dhe kuadrin rregullator perkates. Tarifat e ndryshuara duhet të publikohen dhe t'i behen të ditura Operatorit Përfitues pas njoftimit paraprak dhe miratimit nga AKEP. Për tarifën e publikuar në këtë ofertë referencë dhe që nuk janë objekt rregullimi nga AKEP, Eagle Mobile ka të drejtë t'i ndryshojë duke bërë publikimin në ofertë dhe njoftuar operatorin përfitues të pakten 7 ditë para hyrjes në fuqi të tarifës së re.

c. Shtesa në Aneks 1 për përkufizimin e shërbimit të terminimit;

d. Në tabelën e tarifave për shërbimin 102 (terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare) të shtohet fraza:

Tarife komerciale

Eagle Mobile ka të drejtën e ndryshimit të tarifave për këtë shërbim me një njoftim paraprak 7 (shtatë) ditë derguar me shkrim Operatorit Përfitues

e. Pika 4.3.2 e Aneks IV të ndryshohet si më poshtë:

4.3.2 Informacioni i nevojshëm është si vijon:

4.3.2.1 Dokumentacioni i përgjithshëm ligjor i operatorit përfitues.

4.3.2.2 Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Autorizimit të Përgjithshëm të leshuar nga AKEP bazuar në VKD Nr.1774 datë 02.02.2012 sipas shërbimeve të konfirmuara.

4.3.2.3 Autorizimin Individual të leshuar nga AKEP për secilën nga shërbimet e konfirmuara si më poshtë:

a. për caktimin dhe përdorimin e frekuencave.

b. për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike.

c. Caktimin e Kodit(eve) të Pikave të Sinjalizimit(SPC kombëtare), caktuar nga AKEP sipas rekomandimeve dhe nëse Operatori Përfitues që kërkon të terminojë trafik ndërkombëtar në rrjetin e Eagle Mobile, duhet të disponojë:

ISPC (International SPC) të caktuar nga AKEP sipas rekomandimeve të SS7

Teknologji transmetimi TDM (Time Division Multiplexing) nëpërmjet shtresës fizike të fibrit me rrugezim të mbrojtur e të sigurta deri në pikën e lidhjes me operatorin ndërkombëtar (International Carrier).

4.3.2.4 Dokumentacionin teknik të detajuar si më poshtë:

Propozim mbi vendodhjen e Interkoneksionit.

Struktura e Rrjetit.

Propozim mbi rrugëzimin e trafikut.

Adresat e nyjeve të komutimit.

Menyra e lidhjes dhe infrastruktura që do të përdoret për të arritur deri në pikën e interkoneksionit (ose hapësirën e bashkëvendosjes).

Karakteristikat e pajisjes së transmetimit të përdorur për Interkoneksion.

Karakteristikat e pajisjes së komutimit të përdorur për Interkoneksion.

Shërbimet e kërkuara: zanore, të dhëna, faks, etj.

Seritë numerike që do të përfshihen.

4.3.2.5 Parashikimi për trafikun që do të shkëmbehet.

Ky parashikim duhet të jetë i ndarë vecmas për trafikun kombëtar nga ai ndërkombëtar, duhet të jetë i detajuar për çdo pikë interkoneksioni dhe shërbimi, dhe duhet të përfshijë edhe parashikimin për „Perpjekjet për Thirrje gjate „Oreve të Pikut“, „Trafikun e oreve të Pikut“ (në Erlangs) si dhe numrin e parashikuar të qarqeve 2 Mbit/sek. Historikun e të dhënave për trafikun e gjeneruar nga abonentët e Operatorit Përfitues (origjinim/tranzitim/terminim) sipas raporteve të dorëzuara në AKEP periodikisht.

4.3.3 Në rastin e operatorëve ekzistues, paraqitja e Certifikatës së Konfirmimit të Njoftimit, përditësimit të informacionit dhe përputhshmëria me këto kërkesa, është kusht për të mundur vazhdimin e ofrimit të shërbimeve të interkoneksionit.

f. Pika 4.4.2 e Aneks IV të ndryshohet si më poshtë:

4.4.2 Informacioni i shkëmbyer do të përfshijë:

- a. Informacionin lidhur me planin numerik të caktuar çdo pale dhe numrin e abonentëve ekzistues të Operatorit Përfitues në momentin e paraqitjes së kërkesës për interkoneksion, të vertetuara nga evidencat përkatëse.
- b. Informacionin lidhur me parametrat e cilësive sipas nenit 5 të Rregullores për Akses dhe Interkoneksion dhe Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit bashkëngjitur kësaj Marrëveshje Interkoneksion.
- c. Dokumentacionin përkatës nga AKEP lidhur me aftësinë për të kryer rrugëzimin e duhur të thirrjeve, sipas përcaktimeve të Rregullores “Për Portabilitetin e Numrit”.
- d. Informacion mbi aksesin nga përdoruesit e operatorit përfitues drejt numrave të emergjencës dhe garantimin e informacionit për identifikimin e vendodhjes së personit që ka kryer thirrjen.
- e. Informacion për garantimin e mundësisë për lejimin e përgjimeve të komunikimeve elektronike nga autoritetet kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi për përgjimet në fushën e komunikimeve elektronike.
- g. Shtimi i të drejtës që operatori celular të shprehë kapacitetin e lidhur për trafikun ndërkombëtar, nëse Operatori Përfitues nuk e përdor fare këto kapacitete për një periudhë 2 (dy muaj).

h. Në marrvëshjen e Nivelit të Shërbimit , në Seksion 6 të shtohet pika 6.8 si më poshtë:

Testet e trafikut te behen te ndara ne testet per trafikun Nacional, Internacional dhe testet e MNP.

3. Përveç sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., me shkresa përkatëse i janë drejtuar AKEP-it edhe sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A., dhe AMC Sh.A., duke sugjeruar gjithashtu amendimin e Ofertave Referencë të Interkoneksionit respektive, për të njejtën arsye të parashtruar edhe nga sipërmarrësi Eagle Mobile Sh.A.
4. Pjesa më e madhe e sugjerimeve të të tre operatorëve celularë, të tilla si përfshirja e referencave për Rregulloren e Autorizimit të Përgjithshëm, rregulloreve dhe vendimeve të tjera që kanë lidhje me interkoneksionin dhe ofertat referencë, kërkesat shtesë për shkëmbim informacioni, përfshirjen e përkufizimeve shtesë dhe afate të njoftimit të ndryshimit të tarifave që nuk janë nën-rregullim, si edhe testete e vecanta ne SLA, janë të ngjashme dhe të arsyeshme.
5. Por, disa nga propozimet e sipërmarrësit Eagle Sh.A., nuk konsiderohen të nevojshme, të drejta dhe të bazuara ligjërisht dhe për këtë arsye nuk pranohen nga AKEP-i si p.sh., propozimi për informacion mbi *“Teknologji transmetimi TDM (Time Division Multiplexing) nëpërmjet shtresës fizike të fibrës me rrugëzim të mbrojtur e të sigurtë deri në pikën e lidhjes me operatorin ndërkombëtar (International Carrier), i cili është një përcaktim i pa nevojshëm.*
6. Përveç sugjerimeve që gjejnë përputhje, në shkresat e tre sipërmarrësve drejtuar AKEP-it me të njejtin objekt për amendimin e Ofertave Referencë të Interkoneksionit në zbatim, ka edhe sugjerime të tjera të drejta dhe të bazuara ligjërisht, të cilat me gjithëse janë individuale dhe nuk sugjerohen nga i njejtë sipërmarrës, nga pikpamja rregullatore janë të nevojshme për të qenë pjesë e secilës nga Ofertat Referencë të Interkoneksionit në zbatim të këtyre sipërmarrësve.
7. Sugjerimet e dhëna më sipër, të pranuar nga AKEP-i për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, reflektojnë qëndrimet rregullatore të AKEP-it të vendosura nëpërmjet akteve normative dhe individuale administrative të nxjerra pas periudhës së publikimit dhe hyrjes në fuqi të kësaj Oferte Referencë të Interkoneksionit në zbatim. Ato përmirësojnë ndieshëm kuadrin rregullator lidhur me kushtet për lidhjen e marrëveshjeve të interkoneksionit në përputhje me detyrimet ligjore dhe kushtet aktuale të tregut. Garantojnë më mirë këkesën ligjore për kushtet e veçanta, për ndershmërinë, mosdiskriminimin, transparencën dhe arsyeshmërinë gjatë procesit të negociimit midis sipërmarrësve për lidhjen e MI. Pas miratimit të shtesave dhe ndryshimeve në Ofertat referencë të Interkoneksionit, është e nevojshme që ato të reflektohen edhe në marrëveshjet e interkoneksionit të lidhura nga sipërmarrësi Eagle Mobile Sh.A., me operatorët e tjerë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme, në zbatim të shkronjën c) të nenit 8 dhe nenin 52 të

ligjit nr. 9918 dhe Rregullores Nr. 19, datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të pranojë pjesërisht sugjerimet e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim dhe t’i miratojë ato sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).
2. Përveç sugjerimeve të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., të pranuar nga AKEP-i sipas pikës 1 të këtij dispozitivi, në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, AKEP sipas dokumentit bashkëlidhur (Aneksi 1) vendos edhe disa shtesa dhe ndryshime të tjera që i konsideron të nevojshme.
3. Bazuar në pikën 32.2 të Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A., ndryshimet e pësuara nëpërmjet këtij vendimi do të bëhen pjesë e marrëveshjeve të interkoneksionit të lidhura midis Eagle Mobile-së dhe paleve të tjera, me efekte nga data e përcaktuar nga AKEP për hyrjen në fuqi të tyre, si më poshtë:
 - a. Për hyrjen në fuqi të ndryshimit në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare (nga nën-rregullim në komerciale), do të zbatohet afati i përcaktuar në vendimet e KD të AKEP, Nr.1739, 1740, 1741 dhe 1742, datë 20.12.2011, që ndryshimi hyn në fuqi më datë 01.02.2012;
 - b. Amendimet e Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të miratuara në këtë vendim, do të duhet të hyjnë në fuqi në datën e mbarimit të periudhës tranzitore të përcaktuar në Rregulloren e Autorizimit të Përgjithshëm, pra më datë 09.05.2012.
4. Oferta Referencë e Interkoneksionit me shtesat dhe ndryshimet e pësuara sipas këtij vendimi, të publikohet nga sipërmarrësi Eagle Mobile Sh.A., brenda 7 ditëve pas marrjes së njoftimit vendimit.
5. Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURCE**

ANEKSI 1

SHTESAT DHE NDRYSHIMET NE OFERTËN REFERENCË TË INTERKONEKSINIT NË ZBATIM TË SIPERMARRËSIT Eagle Mobile SH.A., TË MIRATURA NGA AKEP-I ME VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES

Nr. __, DATË ____ .04. 2012

1. Tek Pjesa Kryesore “Përmbledhje” gërmat “c” dhe “e” ndryshohen si më poshtë:
 - (c) Oferta Reference e Interkoneksionit zbatohet për sipermarresit që operojnë në Republikën e Shqipërisë, të cilët janë të autorizuar nga AKEP sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm dhe që kanë të drejtë të interkonektohen, në përputhje me Ligjin 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (Ligji 9918), Rregulloren për Akses dhe Interkoneksion, **Rregulloren për Autorizimin e Përgjithshëm dhe çdo akt tjetër rregullator, që ka lidhje me këto Oferte Reference**, në fuqi të miratuar nga AKEP.
 - (e) Kjo Oferta Reference Interkoneksioni shërben si bazë për Marrëveshjen e Interkoneksionit midis Eagle Mobile dhe operatorit përfitues, marrëveshje e cila do të përfshijë edhe shërbimet e ofruara nga Operatori **Përfitues në përputhje me Rregulloren për Autorizimin e Përgjithshëm**, së bashku me tarifatat përkatëse.
2. Tek Pjesa Kryesore, Seksioni 2. Kuadri Ligjor, pikat 2.2 dhe 2.3 ndryshohen si më poshtë:
 - 2.2. Rregulloren nr.19, datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1300, datë 14.06.2010, i ndryshuar (ketej e tutje ‘Rregullorja e Aksesit dhe Interkoneksionit’); **Rregulloren nr 16, datë 16.04.2010 “Për treguesit e cilesise” miratuar me VKD 1256, datë 16.04.2010; Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me VKD nr 1296, datë 11.06.2010; Rregulloren “Për portabilitetin e numrit” e ndryshuar, miratuar me VKD nr 1219, datë 7.4.2010; VKD nr 1318 datë 14.06.2010 “Për miratimin e specifikimeve teknike për portabilitetin e numrit”; Rregulloren “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD nr. 1774, datë 02.02.2012 si dhe çdo akt tjetër normativ të nxjerre nga AKEP me ndikim në këto Oferte Reference të Interkoneksionit.**
 - 2.3 **Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 1211, datë 31.03.2010, i ndryshuar, që ka përcaktuar Eagle Mobile sipermarres me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe masat rregulluese për këtë status në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin Eagle Mobile dhe në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare në Republikën e Shqipërisë: VKD nr 1505, datë 10.02.2011, VKD nr 1507, datë 10.02.2011 dhe VKD nr 1559, datë 20.04.2011.**

3. Tek Pjesa Kryesore, Seksioni 3, në fund të paragrafit 3.4 shtohet fraza e mëposhtëme:
3.4**dhe çdo akt tjetër normativ i nxjerre nga AKEP me ndikim në këto Oferte Reference Interkoneksioni.**

4. Tek Pjesa Kryesore, Seksioni 32 ndryshon si më poshtë:

32.1 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Oferte Reference, duke përfshirë Aneksin e saj, Amendamentet, Shtojcat dhe Listat e Sherbimeve, behen sipas përcaktimeve ligjore dhe nenligjore dhe janë objekt i miratimit nga AKEP. Ndryshimi i tarifave që nuk janë objekt rregullimi nga AKEP, **hyjnë në fuqi pa miratimin e AKEP, për sa kohë AKEP nuk shprehet me vendim për mosmiratimin/pezullimin e ndryshimit të tyre.**

32.2 Çdo amendim i RIO së Vodafone Albanisë (përveç rasteve në pikën 32.3) që kryhet në përputhje me udhëzimet/vendimet e AKEP e ka lidhje me:

- përcaktimin, rregullimin ose heqjen nga rregullimi i tarifave apo sherbimeve të përfshira në RIO-n e Eagle Mobile;

behët pjesë e marrëveshjes së interkoneksionit të lidhura nga Eagle Mobile me paletë të tjera, me efekte nga data e përcaktuar nga AKEP për hyrjen në fuqi të tyre.

5. Tek Aneksi 1 “Përkufizime dhe Shkurtime”, në pikën 1.1, shtohen përkufizimet e termave:

- “ISPC”: Kodi i Pikes së Sinjalizimit Nderkombëtar (International signalling point code).
- “NSPC”: Kodi i Pikes së Sinjalizimit Kombëtar (national signalling point code).

5.1 Tek përkufizimi i termit “Sherbimi i Terminimit në Eagle Mobile” të shtohen:

- **“Sherbimi i Terminimit të trafikut kombëtar në Eagle Mobile”**
Sherbimi nëpërmjet të cilit Eagle Mobile, në emër të Operatorit Përfutës përcjell Thirrjet kombëtare të këtij të fundit, ose të tranzituara prej tij, nga Pika e Interkoneksionit për në një Pike fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave të abonenteve/pajtimtareve të Eagle Mobile.
- **“Sherbimi i Terminimit të trafikut nderkombëtar në Eagle Mobile”**
Sherbimi nëpërmjet të cilit Eagle Mobile, në emër të Operatorit Përfutës përcjell Thirrjet nderkombëtare, të tranzituara nga ky i fundit, nga Pika e Interkoneksionit për në një Pike fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave të abonenteve/pajtimtareve të Eagle Mobile.

6. Tek Aneks II “Shërbimet dhe Tarifat e Interkonksionit”, germa “b” e pikës 2.3.1.2 të ndryshohet si më poshtë:

2.3.1.2 Sherbimi 102 do te kete ne dispozicion kapacitet (kapacitete) ekskluziv te dedikuar transmetimi, i ndryshem nga ai i sherbimeve te tjera te terminimit.

7. Tek Aneks II “Shërbimet dhe Tarifat e Interkonksionit”, në pikën 2.4.1 numri 102, teksti në Kolonat “Tarifa për Kohëzgjatje”, “Tarifa për Thirrje” të ndryshohet si më poshtë:

Tarife komerciale

Eagle Mobile ka te drejten e ndryshimit te tarifave per kete sherbim sipas përcaktimeve të Seksion 7, Në Pjesa Kryesore të RIO.

8. Tek Aneks IV “Karakteristikat e Përgjithshme të Interkoneksionit” behen ndryshimet si me poshte:

8.1 Pika 4.3.2 të ndryshohet si më poshtë

4.3.2 Informacioni i nevojshem eshte si vijon:

- **Kopje e Çertifikates se Konfirmimit te Njoftimit leshuar nga AKEP ne perputhje me Rregulloren “Per Autorizimin e Pergjithshem”, miratuar me VKD 1774 date 02.02.2012;**
- **Kopje ekstrakti nga Qendra Kombetare e Regjistrimit (QKR);**
- **Propozim mbi vendodhjen e Interkoneksionit;**
- **Struktura e Rrjetit;**
- **Tabelen e rrugezimeve te trafikut nderkombetar duke siguruar te pakten dy rrugezime per secilin destinacion;**
- **Adresat e nyjeve të komutimit;**
- **Menyra e lidhjes dhe infrastruktura qe do te perdoret per te arritur deri ne piken e interkoneksionit (ose hapësiren e bashkevendosjes);**
- **Karakteristikat e pajisjes së transmetimit të përdorur për Interkoneksion;**
- **Karakteristikat e pajisjes së komutimit të përdorur për Interkoneksion;**
- **Shërbimet e kërkuara: zanore, të dhëna, faks, etj dhe pershkrimin teknik per to, ne perputhje me Certifikaten e Konfirmimit te Njoftimit leshuar nga AKEP;**
- **Nese Operatori Perfitues kerkon te kryeje tranzit nderkombetar ne rrjetin e Eagle Mobile, duhet te paraqese te dhenat e Pikes Nderkombetare te Sinjalizimit (ISPC) te caktuar nga AKEP dhe te pakten nje marreveshje perfundimtare te lidhur me operatorin nderkombetar;**

- Seritë numerike që do të përfshihen ne Marreveshje sipas Autorizimit Individual per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike, leshuar nga AKEP;
- Vetedeklarimin lidhur me aftesine per te kryer rrugezimin e duhur te thirrjeve, sipas percaktimeve te Rregullores “Per Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar;
- Parashikimi per trafikun qe do te shkembehën. Parashikimi per trafikun kombetar duhet te jete i i ndare vecmas nga ai nderkombetar, duhet te jete i detajuar per çdo pike interkoneksioni dhe sherbimi dhe duhet te perfshijne edhe parashikimin per ‘Perpjekjet per Thirrje’ gjate "Oreve te Pikut” dhe "Trafikun e oreve te Pikut” (ne Erlangs);
- Historikun e te dhenave per trafikun e gjeneruar nga abonentet e Operatorit Perfitues (origjinim/tranzitim/terminim) sipas raporteve te dorezuara ne AKEP periodikisht
- Procedurat dhe sistemet e informacionit qe kane te bejne me trajtimin dhe matjen e treguesve te cilesise, sipas Rregullores per Treguesit e Cilesise se Sherbimit, perfshire ketu Manualin perkates dhe dokumentat perberes, sipas nenit 7 te kesaj Rregulloreje;
- Vetedeklarimin mbi ekzistencen ose jo te sistemeve qe mundesojne lejimin e pergjimit nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit ne fuqi per pergjimin e telekomunikimeve;
- Masat e marra nga Operatori Perfitues per sigurimin e aksesit pa pengese ne sherbimet e emergjences ne perputhje me seksionin 23 te Aneksit C te Rregullores per Autorizimin e Pergjithshem

8.2. Pika 4.4.2 të ndryshohet si më poshtë:

4.4.2 Informacioni i shkëmbyer do te perfshije:

- Te dhenat mbi tipin e sinjalizimit dhe informacionin lidhur me Kodin(et) Kombetar te Pikave te Sinjalizimit, caktuar nga AKEP sipas rekomandimeve te SS7. [
- Informacionin lidhur me planin numerik te caktuar çdo pale dhe numrin e abonentëve ekzistues te Operatorit Perfitues ne momentin e paraqitjes se kerkeses per interkoneksion, te vertetuar nga evidencat perkatese

9. Tek Aneks VI “Procedura e Parashikimit te Kapacitetit te Interkoneksionit”, në fund të Pikës 6.1 të shtohet paragrafi:

Ne rast se Operatori Perfitues kerkon te tranzitoje trafik nderkombetar ne rrjetin e Eagle Mobile , atehere parashikimi per trafikun nderkombetar duhet te paraqitet i ndare nga trafiku kombetar.

10. Në Marrveshjen e Nivelit të Shërbimit (SLA) , në Seksion 6 të shtohet pika 6.8 si më poshtë:

Matjet per treguesit e cilesise se trafikut te behen te ndara per trafikun e thirrjeve hyrëse me origjinë Kombëtare, Ndërkombëtare dhe trafikun drejt numrave te portuar.